



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS **KOMITETI PËR KOMUNITETE**

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 09 qershor 2020, në mbledhjen e XXIII-të (njëzet e tre) të Komitetit për Komunitete, mandati VI.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, ndërtesa e re e Komunës, dhe filloi në orën 10;10.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Albina Avdiu Kryesuese e Komitetit,

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: Valbona Kadriu-Podvorica, Benjamin Ejupi, Bashkim Syla, Doruntina Hasani, Valmire Lahu ndërsa munguan Mefail Rama dhe Radisav Perović.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin, Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, Xhevat Llugaliu, zyrtar nga Drejtoria e Arsimit, Podujevë, Fadil Babatinca, përfaqësues nga Policia e Kosovës (Stacioni Podujevë), Nexhmedin Feta, nga Policia Kufitare, Gergina Kovacs dhe Lasla Siklosi, përfaqësues nga KFOR.

Rendi i ditës

znj.Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit, e hapi mbledhjen ndër të tjera, konstatoj që janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, besoj që materialin e keni marrë me kohë dhe jeni në njohuri për pikat e rendit të ditës. Nëse ndokush ka diçka për të shtuar urdhëroni nëse jo atëherë e hedhë në votim këtë pikë të rendit të ditës.

Njëzëri u miratua rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës.

1. Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Komunitete mbajtur më 27 maj 2020

Njëzëri, pa vërejtje apo plotësim-ndryshim u miratua Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 6 mars 2020

2. Mësimi nga distanca, vështirësitë dhe sfidat e nxënësve të Komunitetit jo shumicë si pasojë e krijuar nga situata pandemike Covid-19.

znj.Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit, ndër të tjera theksoi, e dimë që pandemia Covid-19 ka sfiduar tërë sistemin arsimor kudo në botë dhe jo vetëm në Kosovë duke i larguar të gjithë nxënësit nga objektet e tyre shkollore, e që të gjitha aktivitetet e tyre mësimore janë ndërprerë në objektet e tyre me vendimin e Ministrisë së Arsimit që mësimi të mbahet në distancë dhe kjo ka ndikuar që

nxënësit e sidomos ata të komuniteteve të mos kenë pajisje të mjaftueshme teknologjike si kompjuterë, lloptop etj, e të gjitha këto kanë rezultuar në ngecje në mësim nxënie.

Për më shumë fjalën ja jap përfaqësuesit të Drejtorisë së Arsimit.

z.Xhevat Llugaliu, përfaqësues nga Drejtoria e Arsimit -DKA, ndër të tjera theksoi, siç jeni në dijeni pas pandemisë MASHT ka marrë vendim që mësimi të mbahet në distancë dhe ne si Drejtori iu kemi përmbajtur një programi të tillë, por është fakt se fillimisht kemi pasur vështirësi deri sa janë kyç nxënësit në këto platformat siç kanë qenë zumi, viberi, dhe të tjerat.

Ministria e Arsimit ka mbajtur mësimin në distancë fillimisht në klasat nga I deri në V, pastaj edhe për klasat VI deri në IX, për çka ne kemi raportet mujore të cilat i kemi bërë gati.

Pothuajse rreth 90% të nxënësve kanë qenë të përfshirë në forma të ndryshme në mësimin nga distanca qoftë përmes televizioneve qoftë përmes mjeteve të ndryshme elektronike nuk kemi pasur ndonjë telash përveç disa mungesave nëse mund t'i quaj ashtu e që edhe në kushte normale të rregullta kemi raste të mungesave por që në përgjithësi ka qenë mirë dhe dua ta përgëzoj Ministrinë e Arsimit në krye me znj.Hykmete Bajrami që ka bërë një punë të jashtëzakonshme ngase ka qenë hera e parë që jemi në një situatë të tillë pandemie dhe ka qenë befasi për të gjithë sepse s'kemi mundur të përgatitemi por që pastaj në kohë rekorde janë mobilizuar i gjithë stafi i Ministrisë. Mësimi nga distanca nuk është sikur në shkolla po megjithatë Ministria ka lëshuar disa udhëzime sa i përket vlerësimit të nxënësve, vijueshmërisë etj.

Nga dje kanë filluar mësimin klasat e IX-ta në objektet shkollore sepse me datë 23 të këtij muaji është caktuar të mbahet testi i arritshmërisë dhe ata nxënës duhet të përgatiten. Më parë në këtë test kanë qenë 100 pikë ndërsa këtë vit do të jenë 80 pyetje nga të cilat sigurisht që nuk do të eliminohen nxënësit por ai-ajo që merr pikë më shumë mund ta zgjedhë Gjimnazin apo shkollat tjera kurse ata që kanë më pak pikë renditen në shkolla tjera sepse nuk i plotësojnë, pra kjo është sipas informatave që kemi. Kemi bërë dezinfektimin dhe pajisjen me maska dhe pajisje tjera mbrojtëse për të gjithë personelin dhe nxënësit në ato shkolla ku ka filluar mësimi, distanca po mbahet dhe çështje tjera të nevojshme.

Sipas informatave që kemi testi në fjalë do të mbahet me 23 qershor 2020 për çka edhe kemi bërë përgatitjet e nevojshme. Më parë në klasë kanë qenë 30 nxënës kurse në këtë vit do të jenë dhe aktualisht janë duke zhvilluar mësimin 15 nxënës të ndarë në distancë të nevojshme.

Nuk mund të them se nuk ka vështirësi për nxënësit dhe kjo vlen për të gjithë jo vetëm për ata të komuniteteve jo shumicë por për të gjithë.

Kompania Elkos ka dhuruar 25 lloptop dhe Ipad të cilët i kemi shpërndarë në tri shkollat e mesme, 8 copë shkolla e mesme e lartë "Fan S Noli", 7 copë shkolla e mesme e lartë "Isa Boletini" dhe 7 copë Gjimnazi "Aleksandër Xhuvani, të cilët ju janë shpërndarë në bazë të kriterëve të vendosura nga Ministria e Arsimit së bashku me Elkos, pra për nxënësit që janë në gjendje të rëndë dhe vështirë sociale, që janë dy e më shumë në një familje, brezi kufitar, ndër ta edhe komuniteti RAE.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, parafolësi nuk i përmendi vështirësitë e komunitetit jo shumicë, sa janë të informuar, sa janë pa pajisje, a janë lajmëruar nxënësit e komuniteteve jo shumicë, sa kanë pasur vështirësi, sa kanë përcjellë mësimin nxënësit e komuniteteve, prandaj do të ishte mirë të kemi sqarime më shumë rreth këtyre gjërave në mënyrë që të shohim pastaj çka kemi mundësi ne të bëjmë si asamblistë dhe pastaj të ndërmarrim ndonjë nismë në Kuvendin e Komunës për t'iu ndihmuar atyre nxënësve.

z.Xhevat Llugaliu, përfaqësues i DKA, theksoi, sa i përket informacioneve të detajuara për nxënësit e komuniteteve jo shumicë do të mund t'i merrnim nga drejtorët e shkollave se çka ju mungon atyre. Ne si Drejtori kemi buxhetin e limituar dhe nuk mund t'iu blejmë pajisje përmes tenderimit, andaj për këtë çështje nuk mund të them diçka më shumë sot sepse nuk kam informata

të mjaftueshme dhe konkrete sa kanë pajisje dhe sa nuk kanë, si dhe çështjeve tjera relevante që ndërlidhen me këtë.

z.Bashkim Syla, theksoi, mendoj që jo vetëm nxënësit e Komuniteti RAE por edhe nxënësit e komuniteteve tjera nuk kanë pasë pajisje për tu kyçur në rrjete të ndryshme, mirëpo për këtë ka qenë ndihmesë mësimi përmes televizionit, mirëpo unë mendoj që Drejtoria e Arsimit duhet të skanoj gjendjen, të shikoj gjendjen e komunitetit RAE e që unë jam në dijeni se një pjesë e tyre nuk kanë pajisje në fjalë madje as internet, andaj të shikohen mundësitë që në të ardhmen të bëhet kompensimi i orëve përmes mësimin shtesë sepse sipas vlerësimit tim të gjithë nxënësit janë mbrapa me mësim nxënie.

z.Xhevat Llugaliu, përfaqësues i DKA, theksoi, ne si Drejtori jemi të gatshëm të realizojmë mësim shtesë dhe kemi staf të mjaftueshëm por ne na duhet leje prej Ministrisë dhe prej Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik. Sipas informatave javën e ardhshme do të filloj mësimi edhe për maturanët sepse do të jetë edhe testi i maturës.

Si do që të jetë ne si DKA jemi të gatshëm të realizojmë mësim shtesë por në bashkëpunim me MASHT dhe me IKSHPK, nëse ata na rekomandojnë se ka lehtësim të masave neve nuk na pengon asgjë të organizojmë verës mësimin shtesë qoftë për nxënës të komuniteteve jo shumicë qoftë për të tjerët.

znj.Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit, theksoi, fillimisht kisha dashur që këtë termin RAE me specifikuar si Rom Ashkalinj dhe Egjiptas sepse termi RAE nuk ekziston.

Kam pyetje për përfaqësuesin e Drejtorisë së Arsimit, meqë më ka rastisë të kem vizita të shumta në shumë Komuna të vendit të cilat kanë shumë bashkëpunim me organizata të ndryshme dhe të cilat kanë ndarë pajisje për nxënës të komunitetit jo shumicë, andaj dëshiroj të njoftohem se ne si Komunë apo DKA a keni një bashkëpunim të tillë me organizatat të ndryshme ose çfarë jeni duke bërë në këtë drejtim. Në fakt përfaqësuesi i DKA-së e ceku se ka pasë një donacion dhe janë ndarë disa pajisje teknologjike në shkolla por jo edhe në lagje andaj dëshiroj të dijë, edhe pse ndoshta përfaqësuesi në fjalë nuk po ka informata të sakta se sa është numri i kërkesave për këtë çështje që u janë drejtuar ju si DKA ose a keni me dalë në terren me pa gjendjen e nxënësve të komuniteteve jo shumicë sepse e dimë që tash në familjet e Komunitetit është numër i madh i fëmijëve të cilët e vijojnë procesin mësimor dhe ata kanë problem që të gjithë fëmijët me i furnizuar me ndonjë lllaptop ose ndonjë telefon të mençur.

E dimë që rezultati i suksesit të tyre ka me qenë shumë i dobët në krahasim me vitet e kaluara për shkak të kësaj gjendje tash nuk e di se çfarë keni me bë më konkretisht në këtë drejtim.

z.Xhevat Llugaliu, përfaqësues i DKA, theksoi, nxënësit prej klasës I deri IX nuk kanë pasë ndonjë telash sepse ka qenë mësimi përmes televizionit RTK.

znj.Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit, theksoi, pajtohem se ka qenë mësimi online përmes TV mirëpo ndoshta ka qenë shumë më përpara ndoshta nuk kanë mundur me u kyç edhe shumica ndoshta nuk kanë pasë edhe në familjet me skemë sociale disa nuk kanë as TV se ku me i ndjekë.

z.Xhevat Llugaliu, përfaqësues i DKA, theksoi, siç e ceka Kompania Elkos ka dhënë donacionin 25 pajisje, (llaptop dhe Ipad) dhe kanë qenë ekskluzivisht për shkollat e mesme, dhe tani ne kemi rreth 5000 nxënës në shkollat e mesme, prandaj analizojeni ju edhe vet se mund të bëhet me 25 pajisje, pavarësisht që shfrytëzoj rastin të falënderoj Elkosin.

Buxheti i Drejtorisë së Arsimit pothuajse harxhuar për dezinfektim dhe nuk kemi pasë mundësi me e pajisë asnjë nxënës me këto pajisje që i përmendi parafolësja, mirëpo nga dje kemi filluar me vizita në terren dhe procesin mësimor me klasët e nënta, marrim raporte dhe shënime të ndryshme nga akterët dhe pastaj do ta shikojmë gjendjen se si zhvillohet mësimi, shohin pengesat ku ka problem, ku ka telashe dhe besoj që edhe javën e ardhme për nxënësit e Komunitetit jo shumicë

do t'i kemi të dhënat më të përafërta në një farë mënyre, përndryshe kështu siç jemi duke punuar nga distanca sipas rekomandimeve të IKSHP, siç po e kërkon ju nuk di si mund t'i marrim informatat konkrete mirëpo mund t'i thërrasim në telefon dhe të marrim informatat e sakta nga vetë familjarët e nxënësve dhe mund ta kemi më të lehtë identifikimin e atyre që kanë nevojë për pajisje teknologjike.

znj. Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit, theksoi, veç se e cekët që buxheti është kufizuar dhe i limituar dhe nuk iu është dhënë hapësirë të ndani buxhet edhe për pajisje teknologjike, po sa jeni munduar që t'i furnizoni nxënësit e komunitetit jo shumicë me materiale tjera si, fletore, goma lapsa e të tjera, apo sa jeni munduar të paktën t'ju dilni në ndihmë me këto pajisje.

z. Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim – ZKKK, theksoi, çështja në fjalë për të cilën po diskutojmë është çështje e cila na ka zënë në befasi të gjithëve pa dallim, mirëpo meqë jemi në Komiteti për Komunitete po diskutojmë për nxënësit e komuniteteve jo shumicë që është edhe ekskluzivisht jemi të thirrur për një gjë të tillë.

Ne si Komunë rregullisht kemi investuar në pajisjet e nxënësve të komuniteteve jo shumicë, qoftë me pajisje shkollore e që jemi Komuna numër një në Kosovë që për çdo vit për nxënësit e shkollave të mesme sepse siç dihet për filloret i ndan Ministria, të gjithë nxënësit e komunitetit jo shumicë që vijnë shkollimin e mesëm kanë marrë nga Komuna të gjitha ato që kanë kërkuar sa i përket procesit mësimor, libra, fletore goma, lapsa e të tjera për gjithë vitin shkollor, për çka i falënderoj Drejtorinë e Arsimit, madje nganjëherë po përtojnë edhe të vijnë t'i marrin në Komunë, sepse konsiderojmë që si Komunë e kemi obligim që t'iu dalim në ndihmë të gjithë atyre, pavarësisht a i kanë kushtet apo jo.

Sa i përket pajisjeve teknologjike mund të themi se kjo është sfidë për të gjithë sepse jemi në situatë epidemiologjike dhe nuk dallon persona, por megjithatë si Drejtori nuk konsideroj se nuk kanë mundësi që në këtë kohë dhe situatë të shkojnë të vizitojnë familjet nëpër lagje.

Kryesuesja bëra pyetje, mirëpo duhet pasur parasysh që ka qenë edhe kufizimi i lëvizjes, distanca, pastaj ne si shtab emergjent kemi ndarë ndihma esenciale në një situatë që ka qenë pothuajse gjendje luftë për jetë nëse mund ta quaj ashtu si dhe ndihmat tjera që janë shpërndarë nga donatorë të ndryshëm. Organizatat humanitare janë organizata të pavarura dhe ato vetë vijnë në Komunë dhe i ndihmojnë ata që kanë nevojë ku institucionet Komunale janë në gatishmëri që të bashkëpunojmë me ato organizata sepse nuk janë institucione kompetent që merret enkas me këto gjëra por ato iu ofrohen institucioneve kompetente lokale në aspektin e bashkëpunimit dhe koordinimit të ndërsjellë mirëpo gjatë kësaj situatë emergjente me Organizatat ndërkombëtare në si OSBE-në, UNHCR, IOM nuk kemi mundur të kemi kontakte të drejtpërdrejta për shkak se ato i kanë rregullat strikte të rekomanduara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë andaj edhe nuk kanë mundur të kenë kontakte të drejtpërdrejta me vizita në lagje dhe vende tjera por kanë marrë informacione prej institucioneve lokale e që ne kemi qenë në gatishmëri dhe në kontakte të vazhdueshme me përfaqësuesit e fshatrave dhe lagjeve të cilët vazhdimisht kanë dhënë informacione për gjendjen e tyre sepse në një formë janë edhe përgjegjës dhe kompetent në këtë kohë qoftë për arsim, shëndetësi, për ndihma sociale etj dhe pastaj të gjitha i bartë në Drejtoritë përkatëse Komunale.

Kompetencë e organeve komunale është kur bëhet kërkesë me shkrim, dhe nëse nuk realizohet ajo kërkesë atëherë mund të bëhen ankesa dhe të jepen arsyetime përse nuk është realizua, andaj të mos ngrisim gjëra absurde dhe të shtrojmë pyetje të llojllojshme ngase të gjithë duhet të jemi në gjendje aktive sa i përket ndihmave dhe gjetjes së zgjidhjeve gjithnjë duke marrë për bazë gjendjen faktike qoftë sa i përket nxënësve qoftë familjeve në nevojë për ndihma etj etj, dhe në këtë aspekt mendoj se ky vit shkollor mund të quhet i humbur për nxënësit.

Nuk jam kompetent për këtë çështje mirëpo arsimi në Kosovë është degraduar shumë më herët për çka kemi edhe shumë raporte dhe rezultate ndërkombëtare, andaj të jemi real sepse në këtë kohë dhe në këtë situatë të flitet për rezultate nga mësimi nga distanca mendoj se nuk mund të kemi rezultate sepse jemi në përpjekje të vazhdueshme në menaxhimin e situatës së krijuar nga kjo epidemi me shumë të panjohura madje edhe për shtet shumë më të forta dhe ekspertët më të mirë botërorë, megjithatë jemi munduar dhe jemi në mundim të vazhdueshëm ta menaxhojmë këtë situatë edhe pse tash së fundmi numri i të infektuarve vetëm po shkon në rritje, por si individ, si njerëz dhe si institucione që jemi duhet t'iu ndihmojmë të gjithë njerëzve që kanë nevojë duke përfshirë edhe të gjithë ata fëmijë që kanë nevojë për pajisje dhe gjëra të ndryshme mësimore.

Në rrethana apo situata tjera ndoshta më të volitshme mund t'i vizitojmë familje për familje, shtëpi për shtëpi në mënyrë që ta dimë gjendjen e reale.

Pra si Komunë marrim informata dhe kërkesa dhe pastaj varësisht mundësive edhe veprojmë me ndihma dhe zgjidhej të çështjeve të ndryshme qoftë për nxënës qoftë për familje me gjendje të rënda socio-ekonomike etj etj. Dhe në këtë aspekt kemi mbi 10 vite që për nxënësit e komuniteteve që vijojnë shkollimin e mesëm iu jepen të gjitha pajisjet teknik që iu vyejnë me lapsa me fletore me libra për të gjithë.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, me gjithë respektin për shefin ZKKK z.Liman Zeqiri dhe për përfaqësuesin e DKA-së i cili është prezent këtu për të jap informata, mirëpo unë edhe në mbledhjen e kaluar e kam thënë dhe kam kërkuar që informatat të sillen në formë të shkruar në mënyrë që të mund t'i analizojmë më mirë.

Nuk pajtohem me atë që u tha se ka qenë kufizim i lirisë së lëvizjes, për shkak se punonjësit përkatës të Komunes e kanë pasë të drejtën e qarkullimit të lirë, dhe nëse Ministria ashtu siç u tha ka bërë një punë të mirë ndoshta edhe Drejtoria kishte mundur ta bënte një punë të mirë dhe atë jo vetëm për nxënësit e Komuniteteve jo shumicë por edhe në aspektin e përcjelljes së procesit të mësimin nga distanca dhe konkretisht se kush ka nevojë dhe kush nuk ka nevojë për pajisje teknologjike, por mendoj që kjo paska është stagnuar andaj edhe kërkoja që informatat duhet të sillen të shkruara që ne të mund të përgatitemi më shumë dhe të kemi edhe informacione më shumë që me na dhënë diçka më serioze, e jo në këtë formë se si u bë deri tani nga përfaqësuesi i DKA-së e që shpresoi se tjera herë do të vlerësohemi më shumë edhe ne si anëtar të këtij Komiteti.

z.Xhevat Llugaliu, përfaqësues i DKA, theksoi, ndoshta tani nuk i posedoj të dhënat në mënyrë telegrafike sepse nuk jam i caktuar për këtë çështje kurse zyrtari që është kompetent është në terren.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, unë e thash se sistemi i mësimin është i mirë mirëpo është e pamundur të përcillet vetëm përmes TV-së dhe këtë e them nga praktika sepse edhe unë i mësoi fëmijët, kam nipa dhe mbesa dhe ata duhet me përcjellë përmes internetit e që ndoshta është pak e rënd të përcillet mësimi vetëm 10 minuta, ndoshta duhet edhe të përsëritet.

z.Xhevat Llugaliu përfaqësues i DKA, përgjigje para folësës, kjo formë e mësim nxënies ka ndodhë për herë të parë te ne dhe ndoshta si shtet nuk kemi përvoja por megjithatë të gjithë jemi përgatitur edhe pse ka pasë telashe në mësim nxënie.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, pajtohem që sfida ka shumë por s'paku ndoshta me u mundu edhe disa zyrtar të arsimit, secili sektor e ka pasë pjesën e vet edhe me pa gjendjen pak më shumë pak më reale siç është dhe me raportuar pak më realisht dhe çka kishim mund me bë ne e dimë që në të gjitha Komunat e Kosovës ka me tepër buxhet shkak se s'kanë mundur me i realizuar projektet gjatë asaj kohe, ne kishim bërë diçka, shembull, me iu ble pajisje ndoshta kishim propozuar po kështu që nuk erdh as diçka ndonjë informacion se sa janë shifrat ose se çka mundemi me bë ne.

z.Xhevat Llugaliu përfaqësues i DKA, theksoi, iu përgjigje parafolëses, ne shifrat mund t'ju japim sa kanë nevojë por prapë nuk është në dorën e Drejtorisë së Arsimit kjo çështje sepse duhet të procedohet pastaj në Kuvend që të ndahet buxhet nga një kategori në tjetrën, shembull, mund të blejmë 50 deri në 100 lllaptop por për më shumë nuk kemi buxhet si Drejtori e Arsimit.

z.Liman Zeqiri i përmendi dhe po dëshiroj të përsërisë atë që e potencoi ai se për tekstet shkollore e vetmja Komuna e Podujevës është që ndanë buxhet për Komunitetet jo shumicë dhe për Komunitetet shumicë që i kanë kushtet e vështira ekonomike, përkatësisht për nxënësit e shkollave të mesme të cilëve ju jepen librat, çanta pajisje tjera shkollore.

z.Liman Zeqiri, theksoi, pajtohem plotësisht me Doruntinën dhe ka të drejtë sepse është mirë që gjithmonë gjërat të vlerësohen ashtu siç janë.

Unë mendoj që kem çalime dhe e pranoi këtë realitet por është mirë të gjendet rrjeti sepse arsimit shkon zinxhir, pastaj janë drejtorët e shkollave të cilët drejojnë një institucion dhe të cilët duhet të pyeten për gjendjen faktike të nxënësve në këtë rast ngase secili drejtor i shkollës është kompetent për institucionin që e drejton, për gjendjen e çdo arsimtari dhe për gjendjen e të gjithë nxënësve

Dhe të gjitha të dhënat duhet t'ia jap Drejtorisë së Arsimit, kurse pastaj kompetentët të kenë statistika të sakta që ju po e kërkon dhe që keni shumë të drejtë e që ka mundur t'i ketë zyrtari përkatës por që për momentin ishte në terren e që do të mund të na ofronte të dhëna që po kërkohe qoftë për mungesën e pajisjeve teknologjike qoftë çështje tjera me theks për nxënësit e Komuniteteve jo shumicë të cilët vërtetë kanë një gjendje më të rëndë ekonomike sociale e të cilët kanë nevoja shumë më të mëdha se sa nxënësit e komunitetit shumicë e që jemi në dijeni se edhe nga komuniteti shumicë ka familje me gjendje shumë të rëndë ekonomike sociale, shëndetësore, mandej jemi në dijeni edhe për gjendjen e bizneseve në këtë situatë epidemiologjike sepse nuk kanë punuar pothuajse për tre muaj.

Asamblistët kanë mundësi ta ngritin në Kuvend të Komunës këtë që po kërkohet dhe të kërkohet buxhet shtesë me ridestitim të mjeteve buxhetore me qëllim që të ndihmohen njerëzit në nevojë, andaj mund të themi se është çështje e cila ndoshta në të ardhmen ta kemi gjendjen më të saktë dhe të jemi më shumë të përgatitur t'iu ndihmojmë qoftë nxënësve, familjeve, bizneseve etj etj.

z.Bashkim Sylja, theksoi, parafolësi **z.Liman Zeqiri** ka të drejtë në shumicën e çështjeve që i ceku, dhe këtë e them duke qenë në njohuri edhe për funksionimin e në fshatin Gllamnik prej nga vie unë, është kryetari i klasës ai i cili prej nxënësve krijon grupin dhe kujdestari i klasës përmes tij i merr informacionet sa persona janë prezent sa janë aktiv dhe i raporton drejtorit të shkollës i cili pastaj ato statistika ti dërgon në Drejtori të Arsimit, dhe ne vetëm këtë po e kërkojmë.

Të gjithë jemi në dijeni që situata është emergjente, nuk është mirë, do të jetë edhe më keq siç po parashihet. Sa i përket mësim nxënies nga distanca unë kam informata por edhe në bazë të asaj që përcjellë fëmijët që kam është një numër i nxënësve të cilët dalin nga grupi dhe nuk marrin pjesë në mësim nxënie, detyra etj, dua të them se ka probleme mirëpo ata që kanë interesim dhe përkushtim sigurisht që kanë mundësi të mësojnë.

Pra një informatë e tillë ka qenë pikë e rendit të ditës i cila ka qenë dashur të jetë më serioze me statistika, shfaqje të problemeve etj etj.

z.Xhevat Llugaliu përfaqësues i DKA, theksoi, raportin për gjendjen në arsim e kemi të gatshëm si drejtori e arsimit dhe të njëjtin e kemi dërguar në Ministri e të cilin mund t'ju a dërgojmë edhe juve si Komitet qoftë në formë elektronike qoftë në forma tjera çfarë dëshironi ju. Raporte të cilat janë tremujore dhe përmbajnë të gjitha çështjet që ju po kërkon që nga niveli parashkollor deri tek niveli më i lartë që organizohet në nivel lokal.

znj.Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit, theksoi, falënderoj të gjithë për opinionin dhe pyetjet e juaja, besoi që në mbledhjen e ardhshme do të kemi përgjigje më të detajuara, andaj e konsideroj të përfunduar këtë pikë të rendit të ditës dhe kalojmë në pikën e radhës.

3. Shqyrtimi i mundësive për organizimin e kurseve për personat e komunitetit jo shumicë të cilët kanë vështirësi në shkrim-lexim.

znj.Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit, theksoi, e dimë që qendrat për mësim nxënie në të dy lagjet ku jetojnë komuniteti jo shumicë por edhe në shkolla veç se janë ndërprerë gjatë kohës së pandemisë, ndoshta kishte me qenë mirë që në të ardhmen të shikohet ndonjë mundësi që përmes donatorëve për organizimin e kurseve për mësim shtesë.

z.Xhevat Llugaliu përfaqësues i DKA, theksoi, përgjigje Kryesueses, nëse lehtësohen masat ne nuk e kemi telashe dhe mundemi të organizojmë mësim shtesë përmes ndonjë organizate ose fundja të organizojmë arsimtarët tanë, mirëpo për momentin pa marrë ndonjë rekomandim prej Ministrisë së Arsimit dhe Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik nuk mund të organizojmë. Vlen të theksohet se me fillimin e mësimin me klasat e IX ne si Drejtori po jemi shumë angazhuar në terren për të përcjellë zbatimin e rekomandimeve nga ana e nxënësve dhe çështjeve tjera.

Do të ishte në interesin tonë si shoqëri të marrim sa më shumë veprime në funksion të mësim nxënies sa më të madhe të nxënësve sepse tani sipas gjitha gjasave do të mbahen testet dhe provimet tjera të planifikuara nga Ministria, por për momentin deri sa të stabilizohet gjendja pandemike nuk mundemi me ndërmarrë hapa konkret.

znj.Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit, ndër të tjera theksoi, a ka dikush diçka për këtë pikë të rendit të ditës nëse jo atëherë kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës.

4. Të ndryshme

Anëtarët e komitetit diskutuar rreth vizitave të planifikuara në fshatra dhe lagje të ndryshme të Komunës së Podujevës, dhe u pajtuan që për këto vizita të shikohen edhe rekomandimet e IKSHP, dhe pastaj varësisht situatës të zhvillohen biseda dhe të caktohet se çfarë të veprohet.

Meqë nuk pati diskutime tjera, Kryesuesja e Komitetit e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:43

Procesverbalin e mbajti

Enis Sheholli

Nr. 01-060/04-0026217/20

Podujevë,

09 qershor 2020

Kryesuese e Komitetit

Albina Avdiu